REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 85/17
Datë/Datum. 24.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: ***(Akademia e Kosovës per Siguri Publike)***

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: ***(214 17 04 136)***

Sa i përket tenderit për (***Furnizim me kompjuter)***

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

ARITECH SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

KM 10 PRISHTINE-LIPJAN,PERBALL QMI-se
(Adresa)

Livaxhe — *(Vendi)*
10500 — *(Kodi postar)*
038-600-500 — *(Numri Telefonit)*
(Numri i Faks-it)

FAHRI AVDIU
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
fahri@aritech-ks.com
(Adresa elektronike)

24.03.2017
(Data e parashtrimit të ankesës)
(Nënshkrimi dhe vula)

SH.P.K. ARITECH PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate eshte publikuar ne KRPP,ne kemi kerkuar dosjen me dt.15.02.17 ndersa kemi pranuar me dt.16.02.2017 h 13:34,afati i fundit per dorezim te ofertes ka qene me dt.24.02.17,hapja e procesverbalit sipas kohes se parapare ka qene ne ora 14:30.
Njoftimi per dhenie kontrate eshte shpallur me dt.07.03.17 ne KRPP,eshte shpallur nje kompani tjeter e cila ka qene e treta per nga çmimi me i lire.
Kompania jone ka qene e dyta per nga çmimi me i lire.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me date 07 mars 2017 kemi pranuar njoftimin per tenderuesin e eleminuar me sqarimin si ne vijim:

Nuk i përmbush specifikat teknike , produkti me te cilin keni ofertuar.

Pas kerkeses sone per te na sqaruar me saktesisht se per cilin produkt eshte fjala qe nuk e permbush specifkimin teknik na eshte komunikuar si ne vijim:

Arsyeja e elimenimit është se në oferten qe e keni në DT:

1. Ne ofert keni ofruar shtepizë form factor Micro Tower ndërsa ne DT është kërkuar MIDI Tower ose Tower
2. Procesorin që keni ofruar është Core i5 5200U me clock speed 2.2ghz ndërsa në DT kemi kërkuar processor me 2.3 Ghz ku e kemi specifikuar qe duhet minimum të jet Core i5 2.3ghz pa Overclocking.

Ne me date 08.03.17 duke u bazuar ne nenin 10 pika 3 te LPP-se kerkuar nga AK te na siguroj qasje ne dokumentet perkatese perkatesisht oferten e dorezuar nga tenderuesi i cili eshte shpalle per dhenie te kontrates.

AK- perkatesisht nga Divizoni i Prokurimit na siguron qasje ne dokumentet e caktuara me dt. 09.03.2017 nga ora 13:00 - 14:00.

Ne kemi prezentuar po ate dite ne kohen e percaktuar dhe kemi siguruar nje kopje te dy produkteve (specifikimet teknike) te dorezuara nga tenderuesi i cili eshte shpalle per dhenie te kontrates.

Ne baze te hulumtimeve tona ne kemi konstatuar qe specifikimet e dorezuara per te dy produktet nga tenderuesi i cili eshte shpalle per dhenie te kontrates gjejme:

Produkti me nr rendor 1.

Llaptop Core I5

Specifikimi e dorezuar nga tenderuesi ofron produktin EliteBook 8570s i cili nuk mund te ofrohet i Ri por i perdorur sespse eshte (Out of sale) jashte shitjes tash e sa vite dhe per te cilin nuk ofrohet garancion qe eshte ne kundershtim me nenin 7 veçanerisht pika 7.2 i cili gjendet ne draft kontrate:

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të **furnizimeve** *[shërbimeve] [punëve].*

7.2 Kontraktuesi duhet të garantojë që furnizimet janë **të reja, të papërdorura, të modelit më të**

fundit.

Ne kemi ofruar model HP 350 G2 i cili eshte i Ri,i paperdorur ,me Garancion te plote dhe qe e permbush piken me lart te nenit 7.2.

Ndersa sa i perket produktit me nr. Rendor 2

Kompjuter Personal (Shtëpizë)

Nje nga arsyet qe ne jemi eleminuar nga AK siç iu kemi referuar edhe me lart eshte:

Ne oferte keni ofruar shtepizë form factor Micro Tower ndërsa ne DT është kërkuar MIDI Tower ose Tower

Ofertuesi i cili eshte shpalle per dhenie te kontrates me produktin e ofruar me poshte:

DELL Vostro 3900 MT
Model Chasis Dell Mini Tower (shih specifikimin bashkangjitur ne Email- te ofertuesit i cili eshte shpalle per dhenie te kontrates)

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7
Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne i kemi deshmuar me argumente te qarta AK-se qe produktet e ofertuara nga OE i cili eshte shpalle per dhenie te kontrates eshte ne shkelje te kushteve te kerkuara.

Kerkesat e AK-se rreth shtepizes paraqesin standarte te dyfishta , perderisa njeri nga operatoret lejohet te ofroje MINI TOWER ndersa OE Aritech shpk I referohet qe nuk I ka permbush kerkesat ne dosje te tenderit.

Per produktin me nr.rendor 2. Kompjuter Personal ,kemi dhene sqarime per Autoritetin tuaj qe operatori ekonomik qe eshte shpalle per dhenie te kontrates ka ofruar MINI TOWER jo MIDI Tower,ne specifikacion eshte shume e qarte qe ka nderhyrje sepse nuk ka njekohesisht shtepize te tille MINI TOWER edhe MIDI TOWER.

Ne cdo kerkim qe kemi bere ne WEB-faqe rreth specifikave te modelit te ofertuar theksohet qarte:

CHASIS
Form Factor - Mini Tower
Manufacturer form Factor - Mini tower (eshte ndryshuar ne specifika te bera vet nga operatori ekonomik)

Prandaj ne theksojme qe ketu ka falsifikim te specifikave!

Shih specifikat e linqeve ne vijim:

https://www.cnet.com/products/dell-vostro-3900-core-i5-4460-3-2-ghz-4-gb-500-gb-us-english-qwerty/specs/
http://www.dell.com/in/business/p/vostro-3900-mini-tower/pd
https://cdn.cnetcontent.com/01/34/0134fc45-3ec6-4cec-8e4f-0e1b7cb08970.pdf

Ne lidhje me Laptopin ne iu kemi argumentuar qe laptop te tille te rinj te ofruar nuk ka tash e disa vite, ka por vetem te perdorur dhe qartesisht jashte garancionit nga prodhuesi (produkte qe jane END of LIFE!!!).

Eshte detyre e AK-se te kontrollon rreth informacionit te ofruar nga ne.

Ne prape me dt. 17.03. iu kemi derguar informacione dhe argumente shtese per t'ju ndihmuar ne lidhje me faktin qe tek oferta nga OE i shpallur fitues behet fjale per produkte qe nuk shiten/prodhohen me (dmth nuk plotesojne kerkesat e AK-se), referojuni ketij 'printscreen'nga faqja zyrtare e DELL. (Gjeni bashkangjitur)

E para behet fjala qartesisht per **MiniTower** (qe ka qene baze per eleminimin tone), e dyta ky produkt ka kohe qe nuk shitet dhe produktet si ky nuk gezojne as suportin e prodhuesit as garancionin dhe as pjese reserve!!!!

Nga AK nuk kemi marr asnje pergjigje rreth informacioneve dhe argumenteve me lart.

Me aq sa eshte deshmuar me larte, AK ka pasur deshmi te mjaftueshme qe te rikthej vendimin per anulim dhe te kthej lenden ne Rivleresim.

LUSIM ORGANIN TUAJ QE KETE LENDE TA KTHEJ NE RIVLERESIM.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Deme materiale direkte eshte humbja e fitimit te mohuar dhe kostot operacionale per ndjekjen e ketij rasti.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.
h) Kërkesa për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*